



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 01.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH. ASIXON, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender "Fushate Vetëdijësuese - Plani i Veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrim të banoreve"** me Nr. Prokurimit: 206-23-3450-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik N.SH. ASIXON e dt.26.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ritender "Fushate Vetëdijësuese - Plani i Veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrim të banoreve" me Nr. Prokurimit: 206-23-3450-2-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 16.04.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 26.05.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në **RIVLERESIM** aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.SH. ASIXON me datë 26.05.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ritender "Fushate Vetëdijësuese - Plani i Veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrim të banoreve" me Nr. Prokurimit: 206-23-3450-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, sot me datë 01.06.2023, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Nuk ka specifikuar.

Pretendimet ankimore:

Për shkak që Personi i cili ka nënshkruar Deklaratën në betim ka autorizim të plotë në kompani, ne kërkojmë nga AK të bëjë rishqyrtimin e ofertës tona.

Bashkëngjitur gjëni autorizimin e noterizuar për Personin Dëshirë Alidema

Dëmet materiale

Nuk ka specifikuar.

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimore të OE

Pranohet pretendimi i OE N.SH. ASIXON nga Prishtina, edhe pse në ofertën e dorëzuar nuk ka prezantuar autorizim për personin znj. Dëshirë Alidema, e cila nuk figuron në të dhënat e biznesit as si pronar e as si e autorizuar, por në kërkesën për Rishqyrtim e ka prezantuar Autorizimin përmes Aktit Noterial të datës 04.11.2020 me të cilin pronari i biznesit z. Arber Canhasi e autorizon znj. Dëshirë Alidema Canhasi, që të ushtroj të gjitha të drejtat dhe të bart të gjitha detyrimet e drejtorit ekzekutiv të nënshkruar çdo kërkesë, kontrata, ankesë dhe çdo dokument tjetër sa herë që kërkohet nënshkrimi i drejtorit për mbarrëvajtjen dhe zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare Arbër Canhasi B.I.(emri i biznesit), N.SH. "ASIXON" (emri tregtar).

OE N.SH. ASIXON është dashtë që këtë dokument ta ofroj në ofertën bazë.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. N.SH. ASIXON
2. Operatoreve ekonomik të interesuar


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit